



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Përmet, më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje automjete për nevoja të Bordit të Kullimit, Mbetjeve dhe Pastrimit në Bashkinë Përmet”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8 - Automjete, 34144400-2 - Automjete për mirëmbajtjen rrugore, 34144512-0 - Automjetet për mbledhjen e plehrave me kompaktor, 42415200-0 - Kamionë pune

VLERA E FONDIT LIMIT: 20 889 667 (njëzetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është: 215 735.48 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzetë e tetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 23.09.2025 është: **96.83**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Përmet**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta

për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/a citohet: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se

operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/a, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarojë se, mjetet objekt i procedurës së prokurimit, do të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Kjo deklaratë, shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor, që mallrat objekt prokurimi, të cilët do të dorëzohen pranë AK, do të shoqërohen me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar, standardeve kombëtare e ndërkombëtare, në funksion të qarkullimit të tyre, konform Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie për mjetet e ofruara, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi gjatë periudhës së garancisë, si dhe periudha e garancisë teknike për secilin mjet, do të jetë si më poshtë:

Garancia e secilit prej mjeteve të reja do të jetë 24 (njëzet e katër) muaj nga data e pranimin (marrjes në dorëzim përfundimtar pas kolaudit të të gjithë mjeteve) nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen të gjitha shërbimet periodike dhe për të gjithë llojet e defekteve të shfaqura nga mjeti gjatë kësaj kohe. Mjetet duhet të riparohen brenda 10 (dhjetë) ditë punë në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve të bashkisë sonë.

Garancia e secilit prej mjeteve të përdorura do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga data e pranimin (marrjes në dorëzim përfundimtar pas kolaudit të të gjithë mjeteve) nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen të gjitha shërbimet periodike dhe për të gjithë llojet e defekteve të shfaqura nga mjeti gjatë kësaj kohe. Mjetet duhet të riparohen brenda 10 (dhjetë) ditë punë në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve të bashkisë sonë.

Afati i testimit të mjeteve me kapacitetin e tyre të plotë të punës, do të bëhet në një periudhë kohore prej 10 (dhjetë) ditë pune. Nëse gjatë kësaj periudhe testimi, mjetet shfaqin avari, këto mjete do të kthehen mbrapsht operatorit ekonomik duke kërkuar zëvendësimin e mjetit dhe jo riparimin e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të garantojnë Autoritetin Kontraktor, se secili prej mjeteve të ofruara, do të ketë garancinë teknike të kërkuar dhe do të riparohen brenda afatit të kërkuar në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionim dhe mbarëvajtjen e punëve të AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë **SSH/EN/ISO 9001- 2015 ose ekuivalente** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit.

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Ne rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën **SSH/EN/ISO**, pasi duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se, certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të krijojë sigurinë, që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar me sukses kontratën. Në lidhje me kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatën e standartit si SSH/EN/ISO, është menduar se, ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN/ISO -s rrit kompetitivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, operatorët ekonomikë pjsëmarrës duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN/ISO, garanton AK që OE konkurues, plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.*

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. FADROME

Viti i prodhimit	Jo me i vjeter se 2003
Ore pune	Jo me shume se 4000
Fuqia	Min. 65 kW – Max.75 KW
Numri i cilindrave	Min.4
Volumi i motorrit	Min. 4400 CC – Max. 4700 CC
Lenda Djegese	Nafte

Sistemi hidraulik

Presioni	Min. 225 bar
Prurja e pompes hidraulike	Min. 160 litra/min
Lloji i pompes	Pompe variable me piston

Frenat

Frenat e kembes	Hidraulike, aktive te 4 rrotat
Frenat e dores	Leve mekanike Hidraulike qe veprojne ne aksin e pasem, me mundsi rregjistrimi te frenimit tek leva.

Transmisioni

Transmisioni	Automatik Min. 6 marshe para + Min. 3 marshe pas
Sistem i levizje	4 x 4
Gomat e pasme (te reja)	18.4/26
Gomat e para (te reja)	12.5/80/18

Sistemi elektrik

Tensioni	12 V
----------	------

Dimensionet dhe karakteristikat e pergjithshme

Lartesia e kabines se mjetit	Min. 2800 - Max. 3000 mm
Lartesia e mjetit per qellime transporti	3600 - Max. 3700 mm
Gjeresia e mjetit mbrapa	Min. 2200 - Max. 2500 mm
Gjeresia e mjetit para	Min. 2400 - Max. 2500 mm
Gjatesia e mjetit	Min. 6000 - Max. 6100 mm
Distance aksiale	Min. 2200 - Max. 2300 mm

Pesha e mjetit

Pesha	Min. 7000 - Max. 9000 kg
-------	--------------------------

Kova e ngarkimit

Kapaciteti i koves	Min. 1.1 m ³
--------------------	-------------------------

Lartësia e ngritjes ne piken maksimale	Min. 3400 – Max. 3500 mm
Lartësia e shkarkimit ne piken maksimale	Min. 2500 – Max. 2600 mm
Gjerësia e koves	Min. 2400 – Max. 2500 mm
Thellessia e germimit	Min. 180 mm

Kova e germimit

Lartësia e ngritjes ne piken maksimale	Min. 6500 mm – Max. 6600 mm
Lartësia e shkarkimit ne piken maksimale	Min. 5500 – Max. 5600 mm
Kova e mbrapme e germimit te jete me gjerësi 20 cm, 40cm dhe 60 cm (mjete te jete i pajisur me tre kova).	
Thellessia minimale e germimit	Min. 5600 mm
Hapja e krahut ne nivel me token ne pjesen fundore te kollones	Min. 6800 mm

Mjeti duhet te jete i pajisur :

Krahe teleskopik per koven e pasme te germimit.
 Linje hidraulike per instalimin e cekicit.
 Cekic hidraulik me kapje te shpejt.
 Kovat e germimit me kapje te shpejte.
 Diferencial me levizje te kufizuar (per rreshqitjet).
 Kova para multifunkionale per germim dhe nivelim.
Makina te jete prodhim i BE (Bashkimit europian)

FOTO ILUSTRUESE



2. KAMION VETËSHKARKUES ME VINÇ

Kamioni duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe i gatshëm për punë.
 Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha pajisjet dhe aparaturat duhet të jenë funksionale dhe konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.
 Gabina duhet të jetë me sistem të ngrohjes dhe ftohjes (Kondicioner).
 Gabina e kamionit te jete me jo me shume se 2 dyer dhe jo me pak se 1+1 vende
 Kamioni duhet të jetë i tipit veteshkarkues me karroceri metalike me permasa:
 -gjatësia e karrocercise jo me pak se 4200 mm
 -gjerësia e karrocercise jo me pak se 2300 mm
 -lartësia e karrocercise jo me pak se 500 mm
 Mjeti duhet te jete me dopio gome ne aksin e pasem.
 Mjeti duhet ti kete nr e gomave 315/80-R22.5, Gomat te jene te reja.
 Kamioni te jete me 2 akse dhe konfigurimi i akseve te jete 4X4

Diferencialet te jene me opsion bllokazhi
Diferencialet duhet te jene me reduktor anesor
Kamio e kamionit te jete manuale me 2 raporte marshesh (malor-fushor), ose automatike
Kamioni duhet te jete me frenues motorri (bllokazh)
Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2005.
Mjeti të ketë jo më shumë se 250 000 - 280 000 km dhe te jete me liber sherbimesh.
Pesha e lejuar e mjetit me ngarkese duhet te jete jo me pak se 17000 kg
Motorri të jetë me naftë me ftohje me lëng me fuqi jo më te vogël se 180 kw
Motorri të jetë në gjendje të mirë dhe të mos ketë rrjedhje vaji.
Kamioni duhet te jete me vinc te montuar pas gabines
Vinci te kete jo me pak se tre hapje hidraulike te krahut dhe pesha ngritese ne piken me te shkurter te jete jo me pak se 3000kg
Makina te jete prodhim i BE (Bashkimit europian)

FOTO ILUSTRUESE



3. FUORISTRADA 4X4 (PICKUP) I RI

Viti i prodhimit	Jo me i vjeter se 2024
Fuqia	Min. 113 kW
Volumi i motorrit	2000- 2400 CC
Emisionit i gazrave	Min. Euro 4
Lenda Djegese	Nafte
Numri i dymve	4
Numri i vendeve	5
Transmisioni, Sistem i levizje	4 x 4
ABS & EBD Shperndarje elektronike e forces se frenimit	
BAS Sistem i ndihmes se frenimit	
BOS Sistemi mbivendosjes se frenimit	
T.S.A. Ndhimesi i stabilitetit te terheqesit	
H.S.A. Ndhima e nisjes ne te perpjete (malore)	
E.S.S. Ndezja automatike e bllokazhit ne frenim energjence	
Airbaget perpara per shoferin dhe pasagjerin	
Xhamat e dymve para mbrapa me komandim elektrik	
Sinjalizues per mosvendosjen e rrypit te sigurimit	
Ajer i kondicionuar	
Timoni me ndihmes hidraulik	
Immobilizer bllokues elektronik te karburantit	
4 disqe celiku 16" me goma 205/ R16, goma te reja	

Mbyllje qendrore me 2 celesa me pult
Rripat e sigurimit perpara me rregullin te lartesisë
Sedilja e shoferit me rregullim te lartesisë
6 ganxha fiksime te mallrave ne karroceri
Karoceria me permasa Min 1470 mm, 1520 mm, 475 mm
Makina te jete prodhim i BE (Bashkimit europian)

FOTO ILUSTRUESE



4. MAKINË TEKNOLOGJIKE PËR MBLEDHJEN DHE TRANSPORTIN E MBETURINAVE PUBLIKE 7.5 TON (I RI)

Mjet totalisht i ri jo më herët se viti 2023 i pa perdorur
Gjatesia totale me gjithë mbistrukture 5000 - 5570 mm
Lartesia totale me gjithë mbi strukture 2300 - 2400 mm
Gjeresia totale me gjithë mbi strukture 2000 - 2100 mm
Mjet me dy akse, distanza midis akseve 2700 - 2800 mm
Pesha totale e mjetit 6500 - 7500 kg
Peshe mbajtja neto 3250 – 3300 kg
Motor diesel intercooler me fuqi min 110 kw /150 kf
Klasa e ndotjes se ambientit euro 6
Cilindrata e motorit 2900 - 3000 cm³
Kambio manuale, marshat para + mbrapa 5 + 1 marsha
Timoni ne krahun e majte
Vende totale ne kabine 3 (1+2)
Frenimi ne te dy akset ne disk, norma CEE me ABS
Suspensionimi perpara/mbrapa amortizator+balestra/balestra
Sistemi elektrik-bateria 12 V (100AH – 760 A (EN))
Depozitat e karburantit/AdBlue 100 litra / 10-20 litra
Aksi i dyte me goma dopio

-Aksesore te ndryshem: Mbyllje e çentralizuar me telekomand, pasqyra elektrike me ngrohje, fener kunder mjegulles, autoradio, levizje e xhamave me menyre elektrike, dritat perpara LED, ndricim automatik i fenerave, rregullim i timonit ne lartesi, limitues shpejtesie 90 km/ore, sigures per mospermbysjen e kabines.

I gjithë kamioni me te gjithë perberesit i konstruktuar sipas normave te Komunitetit Europian.

Mbi struktura - e vlefshme per mbledhjen, ngjeshjen,transportin, vetshkarkimin e mbeturinave publike.

Volumi, kapaciteti mbajtes 5-7 m³

Sistemi i punes hidraulik, oleodinamik

Kapja e kazaneve dhe ngarkim/shkarkimi i tyre mbrapa ne fund te mjetit

Cikli i ngjeshjes 18 – 20 sekonda

Cikli i kapjes dhe shkarkimit te bidonave 15-19 sekonda

Koha e shkarkimit te vaskes 40-45 sekonda

Raporti i ngjeshjes 3:1

Dhoma mbajttese e mbeturinave ne forme vaske trapezoidale

Vaska e ndertuar me material çelik S275JR dhe spesor 3 - 4 mm

Perforcimi i vaskes te behet me material S275JR 3 - 5 mm spesori

Shtrati i vaskes te behet me çelik S275JR 3 - 5 mm spesori

Bokulla dhe perni te vaskes ne material çelik special C 40

Ne fund te vaskes te kete saracineske per shkarkim ujerash 1.5"- 2" (diametri)

-Sistemi i ngarkimit: dy menyra kapje. Takim ne forme "kreheri" per nje apo dy bidona menjehere 60 - 360 litra kapaciteti. Takim ne forme DIN per kazan me kapacitet 1100 litra

-Sistemi i ngjeshjes: Ky sistem te jete konstruktuar ne baze te parimit lopat dhe karel, pra kareli i cili rreshqet ne nje dopio shine metalike dhe lopata e ngjeshjes e montuar ne karel. Ky sistem te vihet ne pune nga dy cifte cilindrash hidraulik, njeri nga te cilet per karelin dhe tjetri per lopaten. Te respektohet norma UNI EN 1501-1 persa i perket cikleve te punes: cikli automatik i vazhdueshem, cikel i vetem, cikel manual me operatorin prezent, cikel i sinkronizuar.

Sistemi i shkarkimit: Shkarkimi te behet me ane te vetshkarkimit, pra ngritjes se vaskes deri ne kendin 90 ° me ane te dy pistonave hidraulik ne menyre qe shkarkimi te behet i plote dhe pa pengesa. Qe mjeti te jete sa me i stabilizuar ne shkarkim duhet te jene prezent dy kembe hidraulike stabilizuese ne fund te mjetit te cilat te zgjaten deri ne toke apo te ngrihen ne menyre automatike sipas levizjes vetshkarkuese te vaskes.

-Komandimi dhe instrumentat ne Kabine: Venie ne pune te fenerave mbi kabine, venie ne pune te fenerit mbrapa i cili duhet per punen naten, buton emergjence, llogarites i oreve te punes, Komandim per marrjen dhe kalimin e forces nga kamioni tek mbistruktura dhe kthimi ne gjendje fillestare, kjo e shoqeruar me ane te nje llampe te ndriçueshme. Komandim i sistemit te shkarkimit si edhe llampa ndriçuese qe tregon venien ne pune.

Komandimi dhe instrumentat jashte ne fund te mjetit - Ne krahun e majte ne pjesen anesore te kete buton emergjence per ndalimin e punes, Komandim ndihmes sipas normave UNI EN 1501-1. Ndersa ne krahun e djathte te jene keto komanda : Buton per zgjedhjen e menyres se ngjeshjes, Buton per fillimin dhe mbarimin e ngjeshjes, buton emergjence per ndalimin e punes, komandim ndihmes sipas normave UNI EN 1501-1. Komandim i sistemit te kapjes se kazaneve apo bidonave.

-Sistemi Oleodinamik te jete bazuar ne marrjen e forces me ane te sistemit PTO i aplikuar ne kamion e mjetit. Ky sistem te jete i kompletuar me pompe me ingranazhe dhe presion te vajit hidraulik deri ne 150 bar, depozit e vajit hidraulik, tregues niveli, tuba flesibel, rakorde, valvola te presionit maksimal te vajit, valvola sigurie ne te gjithë cilindrato oleodinamik, filter vaji ne thithje dhe ne kthim, temperature e punes 70°

-Sistemi elektrik te realizohet sipas normave CEI EN 60529 (CEI 70-1), IP 65.

- Lyerja - Mbistruktura te jete ne ngjyre te bardhe dhe te respektoj menyren e lyerjes me dy duar me boje eposidike me spesor te pakten 90 mikron dhe dy duar me boje zmalt poliuretan me spesor te pakten 90 mikron.

-Aksesore te ndryshem: Mjeti te kete edhe nje seri aksesoresh si p.sh. Tregues akustik i marshes mbrapa, parapeta te gomuar, struktura tubolare metalike anesore per mbrojtjen e njerezve, support mbajtes per vegla pune, nje fener ndriçues rrotullues LED, nje fener ndriçues per te punuar naten. Te jete e pranishme gjithë sinjalistika mbrojttese-treguese sipas normave Europiane.

-Normat e konstrutimit te mbistrukture: konstruktimi i mbistrukture te bazohet ne normat IEC, ISO, ISO-CEN, EN, UNI, CEI, CEI-UNEL.

FOTO ILUSTRUESE



Shënim: Mjetet e përdorura duhet të jetë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agentët atmosferikë, goditjet etj.

Gjendja Fizike:

- Të mos jete i demtuar jashtë dhe brenda kabinës
- Tubat e presionit te vajit të jenë në gjendje të mirë (të pa gripuara)
- Gomat në gjendje të mirë (jo të konsumuara)

***Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë

në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT